



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.01.2020, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 20, 21, 22, 25 nëntor 2019 dhe 5, 10, 11, 12 dhe 16 dhjetor 2019

2. Miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 20 janar – 7 shkurt 2020

3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Europën Juglindore” *(Komision për dhënie mendimi)*

4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për mërkurin” *(Komision për dhënie mendimi)*

5. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aneksin VI të konventës ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973”, të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)” *(Komision për dhënien mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Spartak Braho, Bashkim Fino, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Alban Zeneli dhe Artemisa Malo.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Elda Hoti, Andi Përmeti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marikaj – Drejtoreshë Mjedisi në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Nexhila Kodra – Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lindita Tafaj – Përfaqësuese e ISHP-së

Neranda Daja – Përfaqësuese

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Gjergj Methoxha – Drejtor i Politikave të NATO-s dhe BE-së në Ministrinë e Mbrojtjes

Andreas Kalaja – Specialist në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve në Ministrinë e Mbrojtjes

N/Kolonel Agim Kuçana – përfaqësues i Drejtorisë së Operacioneve në SHPFA

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjetikës

Eltar Deda – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Bledar Karoli – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Elson Thana – Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

HAPET MBLEDHJA

(Mungesë inçizimi)

Ulsi Manja – ...ka pasur një axhendë të ngjeshur në të tria funksionet që i ka ngarkuar Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit: në funksionin legjislativ, në funksionin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit parlamentar, por edhe në funksionin zgjedhës të tij.

Për sa i përket procesit legjislativ, në fokusin e punës së komisionit ka qenë përmbyllja me sukses e paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi dhe në tërësi të gjithë paketës së ligjeve të reformës në drejtësi.

Për vitin 2019, në sesionin e parë të legjislaturës që kaloi, pra në periudhën janar – korrik me tri projektligje: “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat” dhe me vendimin “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut” Komisioni i Ligjeve përmbylli me sukses paketën e plotë të ligjeve të reformës në drejtësi, si pjesë shumë e rëndësishme e procesit legjislativ.

Po ashtu, në funksionin e procesit legjislativ, Komisioni i Ligjeve për vitin 2019 ka miratuar 93 projektligje, nga të cilat për 25 projektligje ka qenë në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe 68 projektligje si komision për dhënie mendimi.

Në kuadër të përmirësimit dhe të përafrimit të projektligjeve me standardet më të mira ndërkombëtare, komisioni ynë ka miratuar 302 amendamente, të cilat janë miratuar edhe në seancë plenare.

Po ashtu, në funksionin legjislativ ky komision ka zhvilluar edhe seanca dëgjimore me grupet e interesit dhe shoqërinë civile, më konkretisht në funksion të ligjit “Për nismën ligjvënësve të shtetasve në Republikën e Shqipërisë”, për projektligjin “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat” dhe për paketën e ligjit antishpifje.

Për sa i përket procesit të mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar, si aspekt shumë i rëndësishëm i punës së këtij komisioni, më lejoni të sjell në fokusin tuaj dhe të medieve që po na ndjekin, se në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve është shumica dërrmuese e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj: janë 14 institucione që raportojnë në Komisionin e Ligjeve, por edhe që janë pjesë e mbikëqyrjes dhe të kontrollit parlamentar të këtij komisioni. Për vitin që lamë pas janë zhvilluar 16 seanca dëgjimore me drejtuesit e institucioneve kushtetuese dhe të atyre të krijuara me ligj, si pjesë e raportimit vjetor të punës së këtyre institucioneve, dhe janë miratuar 9 projektrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së tyre.

Po ashtu, si pjesë e mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar, është edhe raportimi i Ministrisë së Drejtësisë për çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e politikave të qeverisë në luftën kundër kriminalitetit dhe që kanë të bëjnë me organin e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe raportimi i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” lidhur me veprimtarinë e kryer për periudhën nëntor 2018-maj 2019.

Po ashtu, si pjesë e mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar, si aspekt i funksionit të komisionit, kanë qenë edhe vizitat studimore në institucione. Janë realizuar pesë të tilla te Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, tek Autoriteti për Informimin rreth Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Është zhvilluar një vizitë informuese në Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit në Dropull, si dhe një vizitë monitoruese në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore lidhur me zbatimin e reformës territoriale.

Seancat dëgjimore në procesin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit parlamentar janë zhvilluar edhe në kuadrin e nënkomisioneve që ka Komisioni i Ligjeve: atë të Drejtave të Njeriut, të Administratës Publike dhe të Pushtetit Vendor. Janë zhvilluar seanca dëgjimore nga Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut lidhur me të drejtat e grave dhe të vajzave romë; roli i Kuvendit të Shqipërisë në promovimin dhe mbrojtjen e tyre. Po ashtu, është zhvilluar një tryezë konsultimi lidhur me gjendjen, problematikat, vështirësitë, si dhe sfidat me të cilat përballen mbrojtësit e të drejtave të njeriut në Shqipëri; një seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë për mënyrën e zbatimit nga ana e prokurorisë të rekomandimeve të dhëna nga Këshilli i Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2018, si dhe një seancë dëgjimore me Komisionin e Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Të gjitha këto aktivitete, që kanë të bëjnë me procesin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit parlamentar, janë zhvilluar në bashkëpunim me Shërbimin e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe me stafin e Komisionit të Ligjeve.

Për sa i përket funksionit të tretë që ka komisioni, procesit të zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, shumë shkurt, për vitin që lamë pas, ky komision shqyrtoi dy kandidaturat e Kuvendit për në Gjykatën Kushtetuese, të cilat më pas u votuan edhe në seancë plenare; zgjodhi Prokurorin e Përgjithshëm me mandat të plotë kushtetues, si dhe përmbylli procedurën e zgjedhjes së

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili u zgjodh jo më vonë se në seancën e parë plenare për këtë sesion, por procedura për inspektorin e Lartë të Drejtësisë u mbyll vitin që iku.

Po ashtu, Këshilli i Lartë i Prokurorisë përmbylli me sukses ngritjen e SPAK-ut dhe zgjedhjen e drejtuesit të SPAK-ut.

Në funksionin zgjedhës dhe emërues komisioni ka zhvilluar 7 seanca dëgjimore. Konkretisht, për vitin që lamë pas u ripërtëri mandati i zotit Besnik Dervishi, si Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; u zhvillua seancë dëgjimore me kandidaten për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, zonjën Pranvera Strakosha, e cila u konfirmua përsëri për një mandat tjetër, si dhe kemi plotësimin e tri vendeve vakante për komisionerë pranë Avokatit të Popullit.

Po ashtu, Komisioni i Ligjeve, në kuadër të veprimtarisë së Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, përmbylli me sukses zgjedhjen e anëtarit të Shqipërisë pranë Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimin ose të Ndëshkimit Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe përmbylli procesin për një vend vakant për anëtar të Autoritetit për Informimin për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Përsëri në funksionin zgjedhës, emërues dhe shkarkues të krerëve të institucioneve kushtetuese dhe të atyre të krijuara me ligj, ky komision i nderuar ka shqyrtuar edhe kërkesën e një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta.

Të nderuar kolegë,

Në mënyrë të përmbledhur, kjo ishte e gjithë veprimtaria e Komisionit të Ligjeve për vitin 2019 në të tria funksionet që ia ngarkon Rregullorja e Kuvendit: atë ligjvënës, atë të mbikëqyrjes dhe të kontrollit parlamentar, si dhe atë të procesit zgjedhës.

Sfidat për vitin 2020 mbeten të njëjta. Në fokusin e punës së këtij komisioni do të jetë tashmë mbikëqyrja e zbatimit të plotë të reformës në drejtësi. Komisioni do të vazhdojë me të njëjtin ritëm për t'u dhënë suportin e duhur institucioneve të reja të drejtësisë për ta çuar deri në fund një nga reformat më thelbësore në këto 100 vjet parlamentarizëm, që është reforma në sistemin e drejtësisë. Objektivi i shpejtë i punës së këtij komisioni është shqyrtimi dhe miratimi i paketës së ligjeve që kanë të bëjnë me reformën në sistemin e burgjeve, pse jo edhe një projektligj i rëndësishëm, që është ai për dhënien e amnistisë.

Duke u uruar të gjithë kolegëve punë të mbarë dhe me krahë të lehta, dua të falënderoj, pa as më të voglin diskutim, kontributin dhe rolin thelbësor të kolegëve të opozitës në mbarëvajtjen e punës së këtij komisioni, sidomos për sa i përket miratimit të ligjeve me shumicë

të cilësuar. Pa kontributin e kolegëve të opozitës nuk do të ishte bërë i mundur as reflektimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për sa u përket dy ligjeve të reformës në drejtësi: “Për organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”.

Ftoj kolegët e opozitës që edhe në këtë sesion parlamentar kontributi ynë për suportin ndaj reformës në drejtësi të vazhdojë të jetë i njëjti.

Shumë faleminderit!

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 20, 21, 22 dhe 25 nëntor 2019, si dhe të datave 5, 10, 11, 12 dhe 16 dhjetor 2019 të mbledhjeve të komisionit.

Kolegë të nderuar, procesverbalet e mësipërme ju kanë ardhur nëpërmjet postës elektronike. Ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratojen procesverbalet e mbledhjeve sipas datave respektive që citova më lart.

Pikë të dytë të rendit të ditës kemi miratimin e draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 20 janar – 7 shkurt të vitit 2020.

Sipas kalendarit të miratuar në seancë plenare, Komisioni i Ligjeve ka përgatitur kalendarin e punës për periudhën 20 janar – 7 shkurt të vitit 2020.

Ka vërejtje lidhur me kalendarin?

Ju lutem, se i shoh kolegët që kërkojnë kalendarin, pasi nuk e kanë mbi tavolinë dhe, meqenëse e kemi mbledhje të parë të komisionit, teknologjia na e ka krijuar mundësinë, por e ka edhe Rregullorja e Kuvendit, kontrolloni, siç thotë edhe kolegu Shameti, postën elektronike, sepse aty do ta keni!

Kush është dakord me kalendarin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet kalendari i punimeve të komisionit për periudhën 20 janar – 7 shkurt 2020.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Europën Juglindore”, për të cilin komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relatore do të jetë kolegja Braha.

Prezentë sot nga Ministria e Mbrojtjes kemi: zotin Petro Koçi, zëvendësministër, zotin Gjergj Methoxha, drejtor i Politikave të NATO-s dhe të BE-së, zotin Andreas Kalaja, specialist në Drejtorinë e Integritetit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve, si dhe nënkolonelin Agim Kuçana nga Drejtoria e Operacioneve në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Zoti Koçi, mirë se keni ardhur në komision!

Do t'ju lutesha të na bënit shkurtimisht një prezantim të këtij projektligji për kolegët e komisionit, për t'ia kaluar më pas fjalën koleges Ediola Braha, si relatore e këtij projektligji.

Zoti Zëvendësministër, fjala është për ju.

Petro Koçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Shumë të nderuara zonja deputete,

Më lejoni, së pari, që në emër të qeverisë, meqenëse unë jam i pari nga ekzekutivi që marr pjesë në një mbledhje të këtij komisioni, por edhe si ish-parlamentar, t'ju uroj një sesion të mbarë ju dhe të gjithë parlamentit!

Për të sqaruar projektvendimin, pra është projektvendim dhe jo projektligj, dua të them që në kuadrin e frymës euratlantike dhe në zbatim të politikës së fqinjësisë së mirë, të mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit rajonal, në Europën Juglindore funksionon iniciativa e Ministerialit të Mbrojtjes. Në këtë kuadër janë edhe disa marrëveshje ose janë ngritur mekanizma, të cilët zbatojnë këto lloj politikash, ku një nga mekanizmat e ngritur në kuadër të këtij Ministeriali është edhe marrëveshja për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Europën Juglindore, në bazë të të cilit është ngritur Brigada e Europës Juglindore "SEEBRIG". Kjo është një iniciativë dhe një vendimmarrje e cila ka filluar në datën 26. 09.1998 dhe është nënshkruar nga ish-ministri i Mbrojtjes, i ndjeri Luan Hajdaraga. Pjesë e kësaj marrëveshjeje janë: Shqipëria, Italia, Turqia, Greqia, Rumania, Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut.

Që nga ai moment kjo marrëveshje ka pasur disa protokolle shtesë dhe protokolli, për të cilin ne po flasim sot, është i gjashti. Bëhet fjalë për disa ndryshime, përshtatje, që lidhen jo vetëm me përvojën e krijuar tashmë në shumë vite të kësaj marrëveshjeje, por edhe në përputhje me zhvillime të tjera për ta lehtësuar dhe për ta bërë më fleksibël funksionimin e SEEBRIG-ut, pra të Brigadës së Europës Juglindore.

Ky projektvendim është në përputhje me politikat e Republikës së Shqipërisë në kuadër të anëtarësimit në NATO, si dhe në përputhje me politikat e fqinjësisë së mirë, të bashkëpunimit rajonal, të frymës së mirëkuptimit dhe të ndërbesimit mes vendeve të Europës Juglindore.

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me disa ligje që lidhen me politikën e jashtme dhe me politikën e mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë aderimin e vendit tonë në NATO dhe me një sërë ligjesh të tjera që kanë lidhje me këto politika.

Sigurisht, ky protokoll është i detyruar të ratifikohet në Kuvend (pra nga qeveria vjen në Kuvend), sepse kjo është rruga e aprovimit të këtij protokollit, në mënyrë që pastaj të ketë fuqinë për t'u zbatuar nga SEEBRIG-u dhe nga të gjitha instrumentet e tjerë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, në rastin e Shqipërisë, dhe të Forcave tona të Armatosura.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Fjalën e ka kolegja Ediola Braha për të bërë një raportim të shkurtër.

Besoj se zonja Braha e ka raportimin e parë në këtë komision, që përkon edhe me mbledhjen e parë për këtë sesion parlamentar, edhe me kremtimin e 100-vjetorit të parlamentarizmit. Kështu që do të ngelet gjithmonë hera e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjala është për ju, zonja Braha.

Ediola Braha – Faleminderit, zoti kryetar, për hyrjen!

Do të relatoj sot për projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Europën Juglindore”.

Të nderuar anëtarë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punimeve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, jam caktuar relatore për projektligjin në fjalë, për të cilin komisioni ynë është caktuar komision për dhënie mendimi. Komisioni e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacion përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Ratifikimi i protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Europën Juglindore ka për synim përmirësimin e marrëveshjes bazë, pasi është gjykuar se nevojitet më shumë fleksibilitet në vendimet që merren për sa i përket mënyrës se si funksionon Forca Shumëkombëshe e Europës Juglindore dhe brigada e saj SEEBRIG. Nëpërmjet nënshkrimit të këtij protokollit, parashikohet një rritje e ndërveprueshmërisë

ndërmjet vendeve anëtare të Europës Juglindore, duke sjellë rritjen e sigurisë rajonale dhe të stabilitetit.

Krijimi i Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore, në nivelin fillestar të një brigade shumëkombëshe (SEEBRIG), u vlerësua si një mundësi e mirë përgatitjeje e personelit të Forcave të Armatosura të secilit shtet për të qenë të gatshëm për të vepruar më pas, në kuadër të misionëve të NATO-s apo të OKB-së. Vendet nënshkruese të kësaj marrëveshjeje janë 7, konkretisht: Shqipëria, Italia, Turqia, Greqia, Rumania, Bullgaria dhe Maqedonia.

Me kalimin e viteve, me modernizimin e kapaciteteve, me ndërveprimin në rritje me NATO-n, por edhe të vendimeve që janë marrë në kuadër të iniciativës së Ministerialit të Mbrojtjes të Europës Juglindore kanë ndodhur shumë ndryshime edhe në mënyrën e funksionimit dhe strukturën e Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore. Këto ndryshime janë pasqyruar në marrëveshjen bazë nëpërmjet hartimit dhe nënshkrimit të 5 protokolleve shtesë.

Në kuadër të rritjes së fleksibilitetit të ndërveprimit të brigadës shumëkombëshe me njësitë e tjera në operacione të NATO-s, BE-së dhe OKB-së, si dhe të rritjes së eficiencës së funksionimit bazë të forcës, ka lindur sërish nevoja për një amendim të marrëveshjes bazë me një protokoll të gjashtë. Këto ndryshime të marrëveshjes nuk e prekin thelbin, pra nuk prekin parimet mbi të cilat funksionon Forca Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore dhe qëllimi për të cilin ajo u krijua.

Projektligji nuk do të ketë asnjë efekt shtesë në buxhetin e shtetit, përveç detyrimeve të ndërmarra që në anëtarësimin fillestar në vitin 2000.

Në aspektin ligjor vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, si relatore, vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në komision.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Braha!

A ka pyetje nga kolegët?

Bashkim Fino – A mund të bëj një pyetje?

Ulsi Manja - Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Unë jam plotësisht dakord me ju, zoti Kryetar, në fjalën tuaj hyrëse për sa i përket fillimit të sesionit dhe të një evenimenti shumë të rëndësishëm që kemi realisht, në 100-vjetorin e parlamentit shqiptar, ndaj besoj se është e drejta jonë të diskutojmë, të bëjmë pyetje e të tjera me radhë. Në rastin konkret dua të them se 100-vjetori është i parlamentit, nuk është i individëve që e kanë përbërë parlamentin, qofshin ata, të cilët lënë për të dëshiruar, siç thonë disa historianë të sotëm, apo qofshin ata që janë në funksion të kryetarit të partisë. Domethënë, deri më sot ne kemi 100 vjet parlamentarizëm, që kur u krijua nga Kongresi i Lushnjës. Çdo parlament ka përbërjen e tij që, natyrisht, mund të ketë apo jo personalitete, por që të gjithë kanë dhënë ndihmesën e tyre gjatë gjithë këtyre 100 vjetëve në parlamentin shqiptar. Kjo do të thotë se nuk mund të vlerësohemi dot dhe nuk është e drejtë të vlerësohemi nga disa pseudohistorianë apo pseudoakademikë, që kanë qenë më parë në parlament. Pse në kohën kur kanë qenë këta, parlamenti ka pasur përbërje më të mirë dhe më të lartë?! Pse sot, që nuk janë në këtë sesion, kjo përbërje e parlamentit nuk është më e mirë dhe më e lartë?! Ky është një çështje tjetër dhe unë si deputet i Lushnjës gjej rastin të diskutoj. Unë do ta diskutoj në datën 27.

Në datën kur u mbyllën punimet e Kongresit të Lushnjës filloi edhe seanca e parë parlamentare, sepse, në fund të fundit, atje ka filluar rilindja e shtetit të ri shqiptar, pas ngritjes së flamurit në Vlorë. Shikoni ku jemi sot? Sot jemi vend anëtar i NATO-s dhe sot kërkojmë të ratifikojmë disa marrëveshje të rëndësishme. Unë kam një pyetje teknike për zëvendësministrin. Ky protokoll marrëveshjeje të gjashtë shtesë, që ne duhet ta kalojmë urgjentisht, është miratuar më 7 nëntor të vitit 2018, besoj se do të ishte më mirë që ta kishim kaluar që në vitin 2019? Megjithatë, më mirë vonë se kurrë.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Marrëveshja është nënshkruar që në qershor të vitit 2019 nga zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerale Shehu, dhe më pas janë ndjekur hapat e tjerë proceduralë në qeveri dhe në parlament. Kjo marrëveshje nuk është çështje urgjente.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Koçi!

A ka pyetjeje të tjera, apo diskutime nga kolegët? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Europën Juglindore”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Ftoj relatoren dhe këshilltarët e komisionit që të bëjnë gati raportin për t’ia përcjellë komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Falënderoj zotin Koçi dhe stafin e tij për prezencën sot në komision!

Ju uroj ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.01.2020, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aneksin VI të konventës ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet 1973”, i ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Spartak Braho, Bashkim Fino, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Alban Zeneli dhe Artemisa Malo.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Elda Hoti, Andi Përmeti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjetikës

Eltar Deda – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Bledar Karoli – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Elson Thana – Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Ulsi Manja – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aneksin VI të konventës ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet 1973”, i ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)”. Komisioni ynë për këtë projektligj është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është kolegu Edmond Leka.

Sot prezentë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës kemi zotin Artan Shkreli, zëvendësministër; zotin Eltar Deda, drejtor i Përgjithshëm; zotin Bledar Karoli, përgjegjës sektori dhe zotin Elson Thana, specialist.

Zoti Shkreli, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Zoti Shkreli, ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër të këtij projektligji për kolegët e komisionit dhe më pas fjalën e ka zoti Edmon Leka.

Artan Shkreli - Të nderuar anëtarë të komisionit,

I nderuar zoti Kryetar,

Jemi këtu për të diskutuar për projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aneksin VI të konventës ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet 1978”, e cila është ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78).

MARPOL-i është një konventë ndërkombëtare që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit detar. Siç ne e dimë, Shqipëria në hartë është një vend me drejtim vertikal veri –jug, i ballafaquar me detin Adriatik. Vendi ynë, në raport me sipërfaqen, ka një territor relativisht të madh kontakti me detin, ndaj është shumë më e interesuar se vendet të tjera, të cilat për një motiv ose një tjetër kanë aderuar në këtë marrëveshje edhe pse lagen shumë pak nga deti ose nuk lagen fare nga deti, por, megjithatë, kanë një lloj flote, siç është Austria, e të tjera. Kështu që për ne është shumë e rëndësishme që, meqenëse nuk kemi aderuar deri tani në këto azhurnime të konventave, ta kalojmë këtë ligj.

Unë nuk dua të ndalem shumë gjatë, sepse është shumë e thjeshtë, pasi flitet për rregullat e mbrojtjes së ajrit dhe të mjedisit detar. Ne kemi disa qytete detare, sidomos Durrësi, i cili e ndien më shumë ndotjen detare të ajrit dhe kjo vjen kryesisht prej anijeve tona dhe shumë pak edhe prej anijeve të vendeve të tjera. Shumë nga vendet që kanë aderuar në këtë konventë, kanë kontrollin e ndotjeve që shkaktojnë anijet qoftë ndotjet e ajrit, qoftë edhe ndotjet e mjedisit ujor, të cilat nuk janë pjesë e kësaj marrëveshje që do të kalojmë sot. Siç jeni në dijeni, konventa MARPOL është e përbërë nga 6 anekse, siç janë: parandalimi i ndotjes nga naftës, pra nga lëndët e lëngshme ato helmuese dhe transportimet rifuxho; parandalimi i ndotjes nga substancat e dëmshme që transportohen me anije në formë të paketuara; parandalimi i ndotjes

nga ujërat e zeza të anijeve; rregullat për parandalimin e ndotjes që mund të shkaktohen nga mbetjet e krijuara në anije, si dhe rregullat për mbrojtjen e ajrit nga emetimi i gazeve, djegia e karburanteve po nga anijet. Meqenëse ne, si ministri, kemi në dorë të kontrollojmë transportet dhe në njëfarë mënyre edhe stacionimet e këtyre anijeve, sikurse janë portet, na është lënë si detyrë ta çojmë përpara këtë ratifikim, sepse këtë gjë mund ta kishte bërë ndoshta edhe Ministria e Mjedisit. Gjithashtu, dua të shpreh se aderimi në këtë aneks është i rëndësishëm për republikën tonë pasi plotëson një detyrim që Shqipëria ka si shtet anëtar i Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), dhe si shtet kandidat i BE-së. Pra, detyrimet e brendshme kombëtare në këtë rast përputhen edhe me axhendën e *acquis communautaire*, me strategjinë tonë afatmesme. Kjo ndihmon jo vetëm në mbrojtjen e ajrit detar, por, natyrisht, ka efekte edhe në *hinterland*, duke mbrojtur edhe gjithë brezin e tokës që është në kontakt me detin.

Për sa më sipër, ju lutem, për miratimin e këtij projektligji dhe kalimin e tij në parlament.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shkreli!

Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Faleminderit, zoti Kryetar!

Projektligji synon të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së mjedisit detar nga ndotjet e anijeve. Kjo është një nga konventat ndërkombëtare detare më të rëndësishme në fushën e transportit detar për parandalimin e ndotjeve nga anijet. Marrëveshja që propozohet për aderim ka si objekt përmirësimin dhe mirëpërcaktimin e detyrave të institucioneve zbatuese, si dhe të sigurojë standarde të njëjta për të gjitha shtetet anëtare lidhur me kërkesat për sigurimin, parandalimin e ndotjes së ajrit nga anijet. Aktualisht, anijet me flamur shqiptar janë të detyruara të mbajnë certifikata të përmendura në aneksin 6, me anë të të cilave garantojnë se i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret për mbrojtjen e ajrit, pasi konventa i detyron të gjitha anijet që t'i plotësojnë këto kushte dhe t'i mbajnë këto certifikata. Në rastet kur prekin portet detare të një shteti anëtar, administrata detare e këtij porti duhet të inspektojë mbajtjen e këtyre certifikatave edhe nga anijet që mbajnë flamurin e një shteti joanëtar. Mospasja e këtyre certifikatave në bordin e anijes do të sjellë si pasojë moslejimin e lundrimit të anijeve, si dhe do t'i detyrojë pronarët e anijeve që të plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme teknike të kërkuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare, IMO-ja.

Ndryshimet kryesore në këtë aneks kanë si qëllim uljen progresive në rang global të emetimeve të grimcave të ozonit dhe futjen e zonave të kontrollit të emetive të zvogëluara në emetimet e ndotësve të ajrit. Masat e rishikuara priten të kenë një ndikim domethënës të

dobishëm në mjedisin atmosferik, si dhe në shëndetin e njeriut, veçanërisht të atyre njerëzve që jetojnë pranë porteve detare.

Ne propozojmë një ndryshim në këtë projektligj në nenin 1, duke hequr nga ky nen vetëm citimin e rezolutave të viteve 1969-1970. Pra, neni 1 të riformulohet në këtë mënyrë: “Aderimin e Republikës së Shqipërisë në aneksin VI të konventës ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973”, të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe nga ana procedurale është në përputhje me Rregulloren e Kuvendi, kështu që sugjeroj që ta kalojmë për miratim në komision.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

A ka pyetje nga kolegët?

Zonja Hysi e ka kërkuar fjalën dhe më pas zoti Braho.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Turizmit dhe të institucioneve të tjera.

Në fakt, kjo marrëveshje është propozim i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Është projektligj tjetër ai, zonja Vasilika.

Vasilika Hysi – Ju kërkoj ndjesë!

A folët për konventën, për mërkurin?

Ulsi Manja - Jo, për mërkurin e kemi më pas.

Vasilika Hysi – Ju kërkoj ndjesë!

Ulsi Manja – Zoti Braho, keni fjalën për pyetje.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem kolegë, mbani qetësi!

Spartak Braho – Faleminderit, zoti Shkreli!

Unë kam një pyetje më tepër sqaruese, sepse, duke qenë se jam banor i qytetit të Durrësit, jam në dijeni, por desha që të më sqaronit një rrethanë. Çfarë strukturash private, shtetërore, kombëtare, vendase apo ndërkombëtare funksionojnë për ruajtjen e këtij mjedisi?

Ulsi Manja – Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli – Pyetja që bëri zoti Braho është shumë e drejtë dhe më lejoni të shpreh edhe një konsideratë me natyrë personale, në kuptimin që kur u dëmtuan shtëpitë nga tërmeti u ballafaquam realisht me ndotjen e ajrit në portin e Durrësit që vinte nga anijet, sidomos gjatë

momentit të manovrimeve, për hir të së vërtetës, niveli i ndotjes së ajrit ishte shumë i lartë. Eliminimi i ndotjes së ajrit do të garantohet nga ndalimi i përdorimit të lëndëve djegëse që përdorin deri më sot anijet në territorin e Shqipërisë, të cilat kanë një përqindje shumë të lartë të squfurit, por edhe të elementeve të tjera me mikro grimca që shkaktojnë ndotje. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të ketë një ndikim në buxhet, por te kompanitë private, të cilat funksionojnë me këto karburante të lira, do të kenë një ndikim dhe do të detyrohen të përdorin karburant me kualitetet, si të gjitha anijet e vendeve të BE- së, siç parashikohet në këtë marrëveshje. Kjo do të garantojë në mënyrë imediate ruajtjen e mjedisit ajror dhe atij detar nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, nga inspektoratet tona do të bëhen kontrole shumë të sakta për llojin e karburantit që ato do të përdorin.

Ulsi Manja – A ka pyetjeje apo diskutime të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aneksin VI të konventës ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet 1973”, i ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Lidhur me nenin 1 ka një propozim nga kolegu Leka për riformulimin e nenit 1, ku kërkon të hiqet nga teksti pjesa: “...duke përfshirë edhe rezolutat MEPC.271(69) dhe MEPC.278(70)...”.

Artan Shkreli – Për këtë nen nuk ka asnjë problem dhe mund ta mbështesim këtë propozim, por ne i jemi përmbajtur *mot a mot* tekstit të konventës të MARPOL-it, i cili është një dokument bazë që shërben edhe si udhëzues. Ne jemi munduar që të mos i shmangemi kësaj, përderisa nuk sjell ndonjë pasojë.

Ulsi Manja – Në rregull!

Duke qenë se është ratifikim marrëveshjeje, zoti Leka, mendoj se duhet të marrim *mot a mot* atë që ka konventa dhe ta transfuzojmë në projektligj.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë fjala “aderon” duhet të hiqet, pasi është përsëritur dy herë.

Atëherë, kush është dakord me nenin 1 sipas tekstit të projektligjit, duke hequr fjalën “aderon”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji me ndryshimin që sapo kaluam, duke hequr fjalën “aderon”.

Relatori dhe këshilltarët të bëjnë gati raportin për t’ia përcjellë komisionit përgjegjës.

Falënderoj zotin Shkreli dhe stafin e tij për prezencën sot në komision.

Ju uroj ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.01.2020, ora

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligji “Për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për mërkurin”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Spartak Braho, Bashkim Fino, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Alban Zeneli dhe Artemisa Malo.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Elda Hoti, Andi Përmeti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marikaj – Drejtoreshë Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Nexhila Kodra – Përgjegjëse sektori në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lindita Tafaj – Përfaqësuese e ISP-së

Neranda Daja – përfaqësuese

Ulsi Manja – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit të tretë dhe të fundit “Për ratifikimin e konventës së Minamatës “Për mërkurin”. Komisioni ynë për këtë projektligj është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është kolegu Jurgis Çyrbja.

Sot prezentë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kemi zonjën Orneta Çuçi, zëvendësministre dhe zonjën Klodiana Marikaj, drejtoreshë Mjedisit. Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të ftuar kemi zonjën Nexhila Kodra, përgjegjëse sektori në Drejtorinë Juridike; zonjën Lindita Tafaj, përfaqësuese e ISP-së.

Fjalën po ia kaloj zonjës Çuçi për të bërë një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje dhe më pas fjala do të jetë për relatorin, zotin Çyrbja.

Zonja Çuçi, mirë se keni ardhur dhe fjala është për ju!

Orneta Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje!

Ne jemi këtu për ratifikimin e Konventës së Minamatës për Merkurin, e cila u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave në vitin 2014 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2017. Në vitin 2017 Shqipëria ka përfituar një grant nga thjeshtësitë globale për mjedisin, që të punohej në mënyrë sa më efikase për projektligjin kuadër për merkurin.

Përmes PNUD-it, bashkë me Institutin e Shëndetit Publik, kemi punuar një projekt 2-vjeçar që ky projektligj të jetë para jush sot. Veç kësaj, kemi punuar për të përgatitur planin e zbatimit të këtij ligji kuadër dhe, nga ana tjetër, për të bërë edhe një inventar për sasinë e merkurit që kemi sot në Shqipëri.

Nga ana e shëndetit publik dua të specifikoj se merkuri është një element i rrezikshëm kur bashkohet me elemente të tjera, sepse vetë merkuri është element inert, nuk është i rrezikshëm, por nëse shpërbëhet në avuj ose përziehet me elemente të tjera, bëhet shumë i rrezikshëm.

Konventa e Minamatës ka marrë emrin e një vendi të quajtur Minamatë në Japoni, në të cilin pati një problem të jashtëzakonshëm nga shkarkimet e merkurit në det. Asia e merkurit të peshqit, që janë biolaboratorët, biombajtësit më të mirë të kësaj substance, sollën një vdekshmëri të lartë para shumë vitesh në Minamatë. OKB-ja vendosi të përballet me Konventën e Merkurit, e cila është nënshkruar nga 128 shtete dhe është ratifikuar nga 105 shtete.

Në këtë kuadër ky vit do të jetë super viti i merkurit në OKB për fondet e mjedisit dhe fondet e klimës. Vendi ynë është në kohën e duhur për ta ratifikuar, që të përfitojmë nga ky super vit dhe nga super fondet që jep OKB-ja për të përballuar problemet e merkurit.

Problemet e merkurit në Shqipëri nuk janë të mëdha nëse krahasohemi me vendet e rajonit ose vendet e tjera. Probleme të mëdha ka pasur vetëm pas vitit '92 me mbylljen e PVC-

së në Vlorë. Aktualisht, bazuar në inventarin e bërë, në Shqipëri ka rreth 400 kilogramë merkur të vendosur, e matur kjo me të dhënat metodologjike të importit dhe eksportit të tij.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Çuçi!

Po, zoti Çyrbja.

Jurgis Çyrbja – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Siç u tha edhe më sipër, sot në Komisionin e Ligjeve ka ardhur për miratim Konventa e Minamatës për Merkurin, qëllimi kryesor i së cilës janë detyrime që rrjedhin nga angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare që ka vendi ynë për adresimin e problematikave për merkurin.

Konventa e Minamatës është miratuar me vendim qeverie në Republikën e Shqipërisë në vitin 2014 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2017. Aktualisht këtë konventë e kanë firmosur 128 shtete dhe 105 shtete e kanë ratifikuar.

Në vendin tonë problemi konsiston në mbylljen e fabrikës së sodës kaustike në Vlorë në vitin 1992, zonë e cila nuk u trajtua në atë kohë për mbetjet e rrezikshme të merkurit të krijuara gjatë veprimtarisë së fabrikës. Kjo zonë ka qenë në qendër të vëmendjes të disa projekteve studimore për vite me radhë. Studimet e para që janë kryer në këtë zonë janë bërë në vitin 2002, ku u identifikua si *hotspot*. Më pas pati studime në vitet 2004, 2008, 2012 dhe 2016.

Dispozitat e marrëveshjes respektojnë Kushtetutën dhe parimet e saj, respektojnë dhe zhvillojnë të drejtat e fituara në koherencë me zhvillimet ekonomike dhe financiare të vendit tonë. Këto dispozita respektojnë parimet buxhetore të financimit të shpenzimeve të përcaktuara në ligj për menaxhimin e sistemeve buxhetore në Republikën e Shqipërisë, si dhe dispozitave ligjore në fushën e adresimit financiar të kontrollit.

Duke u bërë palë në Konventën e Minamatës për Merkurin, shtetet anëtare mund të përfitojnë nga fondet në kuadër të programit të veçantë për të mbështetur forcimin e institucioneve në nivel kombëtar, për të rritur zbatimin e konventave të Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit, Konventës së Minamatës dhe qasjes strategjike për menaxhimin ndërkombëtar.

Për sa më sipër gjykoj se projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit në aspektin ligjor dhe procedural, ndaj i kërkoj anëtarëve të komisionit ta miratojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – E kisha edhe në lidhje me konventën tjetër për detin dhe për pjesën e Vlorës.

Ulsi Manja – Bëni pyetjen, sepse mund të jetë sugjerim për komisionin përgjegjës.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

I falënderoj përfaqësuesit e ministrisë që e kanë sjellë projektligjin me një relacion disi ndryshe nga shumë relacione që kanë ardhur në Kuvend!

Duke lexuar relacionin e projektligjit, ju theksoni se para miratimit të kësaj konvente është përgatitur një plan veprimi me rekomandimin për ratifikimin e Konventës së Minamatës. Ndërkohë, po në relacion ju thoni se në bashkëpunim me **EDEN** dhe me fondet që keni marrë, është bërë një studim i detajuar i kuadrit ligjor dhe kanë rezultuar shumë mangësi dhe boshllëqe në ligj, për të cilat keni një raport.

E para, Kuvendi ka detyrim vetëm ratifikimin e kësaj Konvente, apo kemi edhe ndryshime të tjera ligjore?

E dyta, sipas Konventës thuhet që shteti duhet të hartojë edhe një strategji dhe plan veprimi. A është hartuar strategjia apo keni shkuar direkt në planin kombëtar të veprimit?

E treta, inventari kombëtar i merkurit. Thuhet se është përgatitur për herë të parë inventari i parë i merkurit, i cili identifikon këto nevoja. Në vlerësimin tuaj a ka nevojë për angazhim të parlamentit në kuadër të kontrollit parlamentar për zbatimin e rregullave, të vendimeve, të legjislacionit, që është aktualisht në fuqi për mbrojtjen e shëndetit? Të them të drejtën, jam shumë e shqetësuar nga përshkrimi që i bëni situatës së vendit tonë pas mbylljes së fabrikës së sodës kaustike, gjendjes dhe nivelit të merkurit në produktet e peshkut të Vlorës, ku shumica e shqiptarëve e shmangin mishin dhe konsumojnë atë?

E dyta, për shëndetin e grave dhe vajzave. Në këtë kuadër, kam edhe një sugjerim. A duhet që Kuvendit, komisioneve përkatëse, të Veprimtarisë Prodhuese, Komisionit të Ligjeve t'u vihen në dispozicion të gjitha mangësitë dhe dobësitë ligjore? Çfarë nevojash ka për plotësimin e ligjeve?

E dyta, çfarë nevojash ka për forcim kapacitetesh?

Kontrolli parlamentar presupozon që Kuvendi mund të ushtrojë kontrolle me anë të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, por edhe Komisionit të Ligjeve, sepse ka të bëjë me të drejtën e jetës, të shëndetit të tyre.

E fundit, ju përmendni një plan të mirë komunikimi me aktorët e interesuar, dhe këtu kam parasysh institucionet. Si e keni menduar sensibilizimin e kësaj çështjeje me publikun,

sepse ka shumë ndjeshmëri dhe një debat të madh për lidhjet e tij me sëmundjen e autizmit, ndaj dua ta theksoj.

E fundit, pak më parë diskutuam konventën tjetër dhe unë dua ta lidh me Konventën e Marpolit, e cila ka të bëjë me ndotjen në det nga anijet. Në raportet e vlerësimit që keni bërë para përgatitjes së kuadrit për të ratifikuar Konventën e Minamatës, a keni konstatuar problematika dhe ndotje të merkurit për shkak të mungesës së rregullave, moskontrollit sa duhet dhe të ndotjes së anijes në territorin e Republikës së Shqipërisë?

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zonja Çuçi.

Ornela Çuçi – Faleminderit, zonja Hysi!

Ekziston një plan kombëtar. Ky është një legjislacion kuadër. Ne sot ratifikojmë vetëm konventën. Pas miratimit të konventës kemi një plan veprimi dhe plotësimi për gjithë kuadrin ligjor. Është evidentuar problematika e kuadrit ligjor. Ne mund t'jua vëmë në dispozicion planin e veprimit të kësaj konvente. Gjithashtu, janë evidentuar problematika për kuadrin ligjor, por edhe në zbatimin e konventës. Problematikat në çështjet mjedisore janë realisht të mëdha dhe problemi më i madh ka të bëjë me kapacitetet laboratorike në të gjitha aspektet e elementeve. Për fatin tonë të mirë, për sa i përket merkurit, kemi dy pika shumë të forta:

E para, Instituti i Shëndetit Publik është në gjendje me të gjitha pajisjet laboratorike për ta evidentuar sasinë e merkurit në elemente të ndryshme dhe, nga ana tjetër edhe Fakulteti i Shkencave është në gjendje për ta evidentuar merkurin.

Ne dje kemi qenë në Komisionin Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese dhe profesor Baraj evidentoi se të dyja këto institucione i plotësojnë kapacitetet për të evidentuar merkurin.

Nga ana tjetër, problematika e merkurit në vend nuk ka këtë lloj spektri, i cila do të mund të shkonte në një informacion masiv të popullsisë për problematikën që ka. Pra, nuk e ka këtë problem, sepse do të shmangnim problematikën e një paniku që nuk ekziston.

Për vajzat dhe për gratë ka vetëm një specifikë, që në fakt ndodh në të gjitha vendet e botës: nuk këshillohen të hanë peshk të egër. Arsyeja ka të bëjë me merkurin dhe periudhën e shtatzënisë. Në këtë periudhë këshillohet në të gjitha vendet e botës, sepse merkuri prek sistemin nervor të fetusit. Për këtë duhet të shmanget ngrënia e peshkut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, mund të vazhdoni, zonja Çuçi.

Ornela Çuçi – E fundit, për projektligjin që u miratua pak më parë, Konventa për Anijet, dua të specifikoj se këto nuk lidhen me njëra-tjetrën, sepse shkarkimet në unë ajër të anijeve nuk kanë të bëjnë me sasitë e merkurit.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Po, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Unë dua të saktësoj një gjë, edhe si deputet i Vlorës. Nuk konstatova ndonjë shqetësim të madh në qëndrimin e ministrisë për atë që tha kolegja Hysi. Përkundrazi, tha se ne kemi shumë pak probleme me merkurin, përveç situatës në uzinën e Vlorës, e cila është trajtuar në disa projekte, që e kanë minimizuar riskun e merkurit në vite dhe Shqipëria nuk ka pothuajse fare rrezik, zysha. Nuk kemi pse të pompojmë opinionin dhe të themi se ka rrezik dhe jemi të shqetësuar. Ne jemi të shqetësuar për kuadrin ligjor, që të mos lëmë hapësira për të ardhmen, por sot nuk ka. Zyshë, ne kemi peshq shumë të shijshëm në Vlorë dhe Sarandë, të cilët mund t'i shijoni dhe i keni shijuar, që janë brenda vlerave europiane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, ju lutem.

Alket Hyseni – Po flas për peshq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem.

Alket Hyseni – Nga studimet e bëra nuk ka pasur situata alarmante. Nga 11 mostra të peshqve merluc dhe barbun, vetë 2 mostra e tejkaluan kufirin e BE-së, por edhe në BE po të marrësh peshk, 2 mostra i tejkalojnë. Edhe te banorët nuk janë norma shumë të larta, ndaj doja ta theksoja këtë, zoti kryetar.

Duke u bashkuar me propozuesit e këtij ligji duhet ta miratojmë këtë konventë, pasi është e rëndësishme për ta futur Shqipërinë në rangun e vendeve që janë largpamëse dhe marrin masa për të ardhmen. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, një sekondë!

Të japë një shpjegim zonja Çuçi dhe pastaj pyetjet e kolegut Leka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Leka.

Edmond Leka – A mund të na japë një informacion zëvendësministrja se sa janë normat e nivelit të merkurit dhe sa është aktualisht niveli i merkurit sot në ish-uzinën e PVC-së?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

Po, zonja Çuçi.

Ornela Çuçi – Për këtë pyetje, ju kërkojmë ndjesë, por nuk i kemi statistikën me vete.

Ulsi Manja – Nuk ka problem, por mund të na e sillni materialin me shkrim para votimit në seancën plenare.

Ornela Çuçi – Patjetër.

Për sa i përket merkurit, në vitin 1992 është evidentuar se ka qenë 100 ton merkur në ish- PVC dhe në momentin e inkapsulimit është evidentuar një humbje në ajër e kësaj sasive. Inkapsulimi që i është bërë ish-uzinës e ka frenuar problemin që kishte. Inventari ka treguar që kemi 400 kilogramë në total në të gjithë vendin dhe kryesisht ka të bëjë me termometrat që importojmë, jo me evidentimin e asaj që kemi brenda.

Nga ana tjetër, peshku është një organizëm lëvizës dhe nuk është e thënë se është kontaminuar, nëse ka këtë përbërje mercuri, sepse ka shkarkime nga Shqipëria. Shumica e shkarkimeve në Mesdhe vijnë nga Sllovenia dhe nga Bosnja.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Çuçi!

Po, zoti Zeneli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një sugjerim për ju si kryetar i komisionit, por edhe për kolegët tanë. Mundësisht edhe ne si pjesë e opozitës, për të gjitha ratifikimet e projektligjeve, konventave apo marrëveshjeve, jemi dakord. Ne gjithmonë i kemi votuar dhe do t'i votojmë pro. Kjo është pozitive.

Kam një sugjerim, që relatorët e projektligjeve të mos jenë vetëm nga ana e maxhorancës. Ju keni mjaftueshëm projektligje në prioritetet politike dhe qeverisëse. Në aspektin tonë si opozitë, kur sjellim projektligje apo mendime ndryshe nga projektligjet tuaja, e dimë që votat tuaja do të jenë kundër. Të paktën në të tilla marrëveshje të jetë ndonjë nga ne relator, sepse nuk bëhet dëm për asnjë. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, sugjerimi i kolegut Zeneli qëndron. Ne sot e filluam aplikimin e sugjerimit që bëri kolegu, kishim kolegen Braha si relatore. Pa diskutim për projektligjet që kanë të bëjnë me përafrim legjislacionit shqiptar me atë të BE-së mund të kemi relatorë edhe nga opozita. Rregullorja lejon edhe bashkërelatorët, mund të kemi projektligje të rëndësishme, ku mund të jenë dy bashkërelatorë për një projektligj, një nga maxhoranca dhe një nga opozita. Pse jo, ky sugjerim vlen për mbarësinë e këtij sesi parlamentar dhe është përgjegjësi imja për të zbatuar Rregulloren.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Minamatës për Merkurin”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Me miratimin e kësaj konvente, ftoj relatorin dhe këshilltarët të bëjnë gati raportin për t’ia kaluar komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenar.

Mbyllet mbledhja e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Faleminderit për prezencën, zonja Çuçi!

Ju uroj një ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës do të njoftohet nga sekretaria e komisionit së bashku me rendin e ditës.

Ditë të mbarë të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA